

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/URDH./2001/24
21 dhjetor 2001

URDHRESË ADMINISTRATIVE NR. 2001/24

**NDRYSHIMI I URDHËRESËS ADMINISTRATIVE NR. 1999/2 MBI ZBATIMIN E
RREGULLORES NR. 1999/4 PËR PËRDORIMIN E VALUTËS SË LEJUAR NË
KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 5 të Rregullorës nr. 1999/4 të datës 2.9.1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për Përdorimin e valutës së lejuar në Kosovë,

Me qëllim të caktimit të euros si valutë që do të përdoret në Kosovë për të gjitha buxhetet, regjistrimet financiare, llogaritë dhe për të gjitha pagesat, duke përfshirë edhe pagesat e detyrueshme,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative.

Rrjedhimisht, kjo Urdhëresë administrative do të ketë formulimin e mëposhtëm që nga data e hyrjes në saj në fuqi:

URDHRESË ADMINISTRATIVE NR. 1999/2

**ZBATIMI I RREGULLORES NR. 1999/4 PËR PËRDORIMIN E VALUTËS SË
LEJUAR NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 5 të Rregullores nr. 1999/4 të datës 2.9.1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për Përdorimin e valutës së lejuar në Kosovë,

Me qëllim të caktimit të euros si valutë që do të përdoret në Kosovë për të gjitha buxhetet, regjistrimet financiare, llogaritë dhe për të gjitha pagesat, duke përfshirë edhe pagesat e detyrueshme,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative.

Neni 1
Buxhetet, regjistrimet financiare dhe llogaritë

Në pajtim me nenin 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr.1999/4, buxhetet, regjistrimet financiare dhe llogaritë e të gjithë personave fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe ndërmarrjet private, organet publike, agjencitë apo institucionet dhe UNMIK-un, do të paraqiten në marka gjermane (DM) ose në euro deri më 31 dhjetor 2001, e pastaj do të paraqiten vetëm në euro.

Neni 2
Pagesat e detyrueshme dhe taksat administrative

2.1. Në pajtim me nenin 4.1. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 valuta e caktuar për pagesat e detyrueshme deri më 28 shkurt 2002 do të jetë DM ose euro e pastaj pagesat do të bëhen vetëm në euro.

2.2. Në pajtim me nenin 4.2. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4, taksa administrative për personin që dëshiron të bëjë pagesa të detyrueshme në dinarë do të jetë 10% më e lartë se vlera e pagesës së detyrueshme.

2.3. Taksat administrative dhe pagesat e detyrueshme, nëse paguhen me dinarë, do të llogariten sipas kursit më të ri të këmbimit të caktuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës.

Neni 3
Pagesat që kërkohen sipas ligjit në fuqi dhe marrëveshjeve kalimtare

3.1. Nga 1 janari 2002, çfarëdo referimi ndaj ligjit në fuqi për një shumë të pagueshme në DM do të zëvendësohet me shumën ekuivalente në euro me kursin një E=1,95583 DM.

3.2. Për periudhën kalimtare deri më 28 shkurt 2002 të gjitha pagesat, duke përfshirë edhe pagesat e detyrueshme mund të vazhdojnë të paguhen në DM.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Udhëresë administrative hyn në fuqi më 21 dhjetor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm